

URDHËR
Nr. 651, datë 1.11.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, z. Erzen Tola, si vijon:

a) autorizimet për dërgim me shërbim të nëpunësve civilë dhe punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

b) vënien në zbatim të programit institucional të transparencës dhe rishikimin e tij, sipas së njëjtës procedurë që është miratuar, në zbatim të legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit;

c) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

d) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit;

e) të nënshkruajë marrëveshje për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e së drejtës së subjektit aplikues për ofrimin e testeve ndërkombëtare, për të gjithë kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

f) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

3. Çdo urdhër i mëparshëm delegimi që bie në kundërshtim me organin e deleguar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm, nëpunësit civilë dhe punonjësit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi